

**Letër e hapur  
Kryetarit të Komunës së Gjilanit z. Qemail Mustafa**

I nderuari z. Mustafa,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Investimet në vlerë mbi 100 milion euro (premtim i Kryeministrit Hashim Thaçi për Gjilanin);
- Hapjen e universitetit publik në Gjilan (premtim i dhënë nga Kryeministri Thaçi);
- Krijimin e 4 mijë vendeve të punës dhe pagat më të larta (punësimin e më shumë se 1000 personave në secilin vit);
- Përmirësimin e tregut të gjelbër, dhe krijimin e kushteve më të mira për shitësit;
- Investimet në bujqësi me vlerë mbi 6 milionë euro;
- Investimet në industri, ndërtimtari dhe turizëm;
- Krijimin e kushteve më të mira për rritjen e investimeve të huaja dhe vendore;
- Ndërtimin e parkut industrial prej dhjetëra hektarëve, ku investitorët e brendshëm dhe të jashtëm do të kenë mundësi të investojnë;
- Ndarjen e një pjese të madhe të buxhetit për OJQ-të;
- Hapjen e shkollave të reja dhe reformimin e shkollave ekzistuese;
- Investime në pajisje shkollore e kabinete;
- Ndërtimin e sallave dhe terreneve për sport;
- Krijimin e një ambienti ekologjik në shkollë dhe jashtë saj;
- Ndërtimin e shkollës së re në fshatin Kishnapole;
- Mundësimin e mbarëvajtjes së praktikës për studentët;
- Decentralizimin e administratës dhe vendosjen e saj pranë qytetarit;
- Ndërtimin e objektit të ri për administratën dhe kuvendin;
- Investimet e dukshme ne lagjen Arbëria;
- Investime në energjetikë, ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara, parkingje, unazën transitore; ndërtimin e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, trajtim të mbeturinave dhe ujërave të zeza;
- Kolektimin e ujërave të zeza ne gjithë fshatrat e mëdha dhe pastaj trajtimin e tyre në një fabrikë ;
- Përfundimin e projektit për pastrimin e lumit Mirusha;
- Realizimin e projektit për trajtimin e lumit Stanishor;

- Ndërtimin e një qendre multi-kulturore, ku do të vendosen të gjitha grupet rinore, teatrale dramatike, muzikore, figurative, dhe ku do të ketë hapësirë të mjaftueshme, si dhe kushte ideale për punë dhe aktivitete rinore e kulturore;
- Renovimin e teatrit;
- Mbështetje për Qendrën socio-kulturore Don Bosko;
- Ndërtimin e bibliotekës së re;
- Ndërtimin e një parku me një qendër rekreative sportive, në hapësirën e zbrazët që dikur ishte treg i kafshëve;
- Investime në terrene sportive, stadione dhe palestra;
- Ndërtesë të re për QKMF-në;
- Hapjen e QMF -ve të reja;
- Renovimin dhe furnizimin me pajisje të reja për QMF-të ekzistuese;
- Investime në ndërtimin e shtëpisë për të moshuarit;
- Mbrojtjen dhe respektimin e Planit Zhvillimorë Urban;
- Krijimin e planeve rregulluese;
- Krijimin e mundësive për trafik racional dhe efikas;
- Investime në NP "HIGJIENA" dhe NP "HIDROMORAVA"

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP  
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)